

VENDIM
Nr. 356, datë 24.4.2013

PËR NJË SHITESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 933, DATË 17.11.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT ADMINISTRATIV TË KËRKESAVE DHE MASËS SË DËMSHPËRBLIMIT FINANCIAR PËR FAMILJARËT E VIKTIMAVE TË EKZEKUTUARA PADREJTËSISHT, PA GJYQ, PËR MOTIVE POLITIKE, GJATË PERIUdhËS 30.11.1944 DERI MË 1.10.1991”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të tretë, të nenit 2 të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 933, datë 17.11.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet shtesa dhe ndryshimi si më poshtë vijon:

1. Pas shkronjës “c/1” të pikës 6 të shkronjës “A” “Fillimi i shqyrtimit të kërkesave”, shtohet shkronja “c/2”, me këtë përmbajtje:

“c/2. Aktin administrativ të dhënë pas datës 1.10.1991 apo vendimin e gjykatës, që provon faktin e ekzekutimit pa gjyq, për motive politike, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.”.

2. Pika 7 e shkronjës “B” “Shqyrtimi i kërkesës”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha